



**KOMPANIA E SIGURIMEVE ELSIG  
SH.A.**

**Raporti i Auditorit të Pavarur dhe  
Pasqyrat Financiare për vitin e  
përfunduar më 31 Dhjetor 2024**

| Përmbajtja                                                             | Faqe   |
|------------------------------------------------------------------------|--------|
| Raport i auditorit të pavarur                                          | 1      |
| Pasqyra e pozicionit financiar                                         | 4      |
| Pasqyra e fitimit apo humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse | 5      |
| Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet                                       | 6      |
| Pasqyra e rrjedhës së parasë                                           | 7      |
| Shënimet për pasqyrat financiare                                       | 8 - 39 |
| Aneks Pasqyrat Plotësuese                                              |        |

## RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

Për menaxhmentin dhe aksionarët e ELSIG SH.A.

### Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të ELSIG SH.A. ("Kompania"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2024, si dhe pasqyrën e fitimit apo humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e mbetjeve neto që i atribuohen zyrës qendrore dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar në këtë datë, dhe shënimet tjera shpjeguese për pasqyrat financiare duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Kompanisë së sigurimit më 31 Dhjetor 2024 dhe performancën e saj financiare, ndryshimet në fonde dhe rrjedhën e parasë për periudhën që ka përfunduar në këtë datë në përputhje me Rregullat dhe Rregulloret e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, siç është zbuluar në shënimin 3 të pasqyrave financiare.

### Baza për Opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Dega në përputhje me *Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë* (Kodit IESBA), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

### Theksim i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen të Shënimi 3.29 të pasqyrave financiare shoqëruese, i cili shpjegon ri-paraqitjen e pasqyrave financiare të Kompanisë për periudhat që përfundojnë më 1 Janar 2023 dhe 31 Dhjetor 2023, në përputhje me kërkesat e SNA 8 - *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*. Kjo ri-paraqitje është bërë për të rregulluar balancat hapëse të qirave sipas SNRF 16. Opinionit ynë nuk është modifikuar për shkak të kësaj çështjeje.

### Raportimi në informatat tjera

Menaxhmenti është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacioni tjetër përfshin një shtojcë e cila përmban "Margjinën e Solvencës", "Llogaritjen e Kapitalit" dhe "Asetet në mbulim të provizioneve teknike".

Opinionit ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim asnjë formë të konkluzionit të sigurisë mbi to.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informatat e tjera dhe, duke vepruar kështu, të shqyrtojmë nëse informatat e tjera janë materialisht në kundërshtim me pasqyrat financiare ose njohuritë tona të fituara në auditim, ose përndryshe duket se përmbajnë gabime materiale.

Nëse, bazuar në punën tonë të kryer, arrijmë në përfundimin se informacioni tjetër përmban pasaktësi materiale, ne duhet të raportojmë këto rrethana. Në lidhje me këtë dhe bazuar në procedurat tona të kryera, raportojmë se:

- Informacioni tjetër është, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me pasqyrat financiare të audituara;

Dhe, bazuar në njohuritë dhe kuptimin tonë të Degës dhe mjedisit të saj të fituar gjatë auditimit, nuk kemi identifikuar ndonjë pasaktësi materiale të fakteve të lidhura me informacionin tjetër.

### **Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe atyre të ngarkuar me qeverisjen e pasqyrave financiare**

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për një kontroll të tillë të brendshëm që menaxhmenti përcakton se është i nevojshëm për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që janë pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Degës për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likujdohë Degën apo të ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativë tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë.

Personat të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë.

### **Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare**

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë. Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritët të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreziqe, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrolleve të brendshme.
- I kuptojmë kontrollet e brendshme relevante për auditimin me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshëm të Kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmenti, duke u bazuar në dëshmitë e siguruarat të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushteve që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e kompanisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo, nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë që kompania të pushojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

**Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)**

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Kompanisë, në mes tjerash, edhe për fushëveprimin e planifikuar dhe kohën e auditimit, si dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që identifikojmë gjatë auditimit.

**Ne konfirmojmë se:**

Ne nuk kemi ofruar shërbime të ndaluara jo-auditimi të përmendura në nenin 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2019 dhe kemi qenë të pavarur nga Kompania në kryerjen e auditimit.



Amir Dërmala  
Partner i angazhimit  
BDO Kosova L.L.C.  
30 Prill 2025  
Rr. Ukshin Hoti, Ob. C 4/3, Hy. A, Kati II,  
Prishtinë, Kosovë



BDO Kosova L.L.C.  
audit, accounting and financial advisory  
Prishtina, Kosova

KOMPANIA E SIGURIMEVE ELSIG SH.A.  
Pasqyra e Pozicionit Financiar  
Më 31 Dhjetor 2024

| Shënim                                        | Më 31 Dhjetor<br>2024<br>(në EUR'000) | Më 31 Dhjetor<br>2023<br>(në EUR'000) |
|-----------------------------------------------|---------------------------------------|---------------------------------------|
| <b>PASURITË</b>                               |                                       |                                       |
| <b>Pasuritë Qarkulluese</b>                   |                                       |                                       |
| Paraja dhe ekuivalentët e parasë              | 7                                     | 2,439                                 |
| Depozitat me afat                             | 8                                     | 12,751                                |
| Investimet në instrumentet financiare         | 9                                     | 11,352                                |
| Pjesa e risiguruesve në detyrimet e sigurimit |                                       | 3,103                                 |
| Kostot e shtyra të blerjes                    | 10                                    | 1,237                                 |
| Llogaritë e arkëtueshme nga sigurimet         | 11                                    | 1,658                                 |
| Pasuritë e tjera                              | 12                                    | 1,347                                 |
| <b>Gjithsej pasuritë qarkulluese</b>          | <b>33,887</b>                         | <b>28,244</b>                         |
| <b>Pasuritë jo-qarkulluese</b>                |                                       |                                       |
| Prona, impiantet dhe pajisjet                 | 13                                    | 830                                   |
| Pasuritë e paprekshme                         | 14                                    | 6                                     |
| Asetet me të drejtën e përdorimit             | 15                                    | 359                                   |
| <b>Gjithsej pasuritë jo-qarkulluese</b>       | <b>1,195</b>                          | <b>749</b>                            |
| <b>GJITHSEJ PASURITË</b>                      | <b>35,082</b>                         | <b>28,993</b>                         |
| <b>EKUITETI DHE DETYRIMET</b>                 |                                       |                                       |
| <b>Ekuiteti</b>                               |                                       |                                       |
| Kapitali aksionar                             | 20                                    | 4,333                                 |
| Fitimet e mbajtura                            |                                       | 3,571                                 |
| <b>Gjithsej ekuiteti</b>                      | <b>7,904</b>                          | <b>6,526</b>                          |
| <b>DETYRIMET</b>                              |                                       |                                       |
| Detyrimet bruto të dëmeve                     | 16                                    | 14,476                                |
| Provizioni për primet e pafituara             | 17                                    | 9,915                                 |
| Detyrimet nga sigurimi                        | 18                                    | 1,308                                 |
| Detyrimet tjera                               | 19                                    | 1,113                                 |
| Detyrimet e qirasë                            | 15                                    | 366                                   |
| <b>Gjithsej detyrimet</b>                     | <b>27,178</b>                         | <b>22,467</b>                         |
| <b>GJITHSEJ EKUITETI DHE DETYRIMET</b>        | <b>35,082</b>                         | <b>28,993</b>                         |

Autorizuar nga menaxhmenti për botim dhe nënshkruar më 30 Prill 2025.

Rexhep Idrizaj  
Drejtor Gjeneral



Valdete Cikaqi  
Drejtoreshë Financiare

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri 28 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**KOMPANIA E SIGURIMEVE ELSIG SH.A.**
**Pasqyra e fitimit apo humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse**
**Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2024**

|                                                         | Shënim | Për vitin që ka<br>përfunduar më<br>31 Dhjetor 2024<br>(në EUR'000) | Për vitin që ka<br>përfunduar më<br>31 Dhjetor 2023<br>(në EUR'000) |
|---------------------------------------------------------|--------|---------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------|
| Primet e shkruara bruto                                 | 21     | 19,501                                                              | 15,808                                                              |
| Minus: Primet e lëshuara për ri-siguruesit              |        | (1,895)                                                             | (1,922)                                                             |
| <b>Neto primet e shkruara</b>                           |        | <b>17,606</b>                                                       | <b>13,886</b>                                                       |
| Ndryshimi neto në provizionin e primeve të pafituara    |        | (1,402)                                                             | 155                                                                 |
| <b>Primet neto të fituara</b>                           |        | <b>16,204</b>                                                       | <b>14,041</b>                                                       |
| Komisioni nga risiguruesit                              |        | 596                                                                 | 399                                                                 |
| Të ardhurat nga interesi                                |        | 773                                                                 | 589                                                                 |
| Shpenzimet e interesit për detyrimet e qirasë           |        | (28)                                                                | (22)                                                                |
| Të ardhurat tjera                                       | 22     | 455                                                                 | 264                                                                 |
| <b>Gjithsej të hyrat</b>                                |        | <b>18,000</b>                                                       | <b>15,271</b>                                                       |
| Dëmet e ndodhura                                        | 16     | (10,253)                                                            | (8,064)                                                             |
| Pjesa e shpenzimeve për BKS-në                          |        | (272)                                                               | (440)                                                               |
| Nënshkrimi dhe kostot e blerjes së policave             |        | 225                                                                 | 126                                                                 |
| Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit               | 13,14  | (126)                                                               | (96)                                                                |
| Zhvlerësimi i aseteve me të drejtën e përdorimit        | 15     | (506)                                                               | (358)                                                               |
| Shpenzimet administrative                               | 24     | (5,474)                                                             | (5,439)                                                             |
| <b>Gjithsej shpenzimet</b>                              |        | <b>(16,406)</b>                                                     | <b>(14,271)</b>                                                     |
| <b>Fitimi para tatimit</b>                              |        | <b>1,594</b>                                                        | <b>1,000</b>                                                        |
| Tatimi në korporata                                     | 25     | (457)                                                               | (377)                                                               |
| <b>Fitimi neto për vitin</b>                            |        | <b>1,137</b>                                                        | <b>623</b>                                                          |
| Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse                     |        | -                                                                   | -                                                                   |
| <b>Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin</b> |        | <b>1,137</b>                                                        | <b>623</b>                                                          |

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri 28 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

KOMPANIA E SIGURIMEVE ELSIG SH.A.  
Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet  
Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2024

|                                                           | Kapitali aksionar<br>(në EUR'000) | Fitimet e<br>mbajtura<br>(në EUR'000) | Gjithsej<br>(në EUR'000) |
|-----------------------------------------------------------|-----------------------------------|---------------------------------------|--------------------------|
| Bilanci më 1 Janar 2023                                   | 4,333                             | 2,570                                 | 6,903                    |
| Fitimi për vitin                                          | -                                 | 623                                   | 623                      |
| Tërheqje e dividendës                                     | -                                 | (1,000)                               | (1,000)                  |
| Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse                       | -                                 | -                                     | -                        |
| <b>Bilanci më 31 Dhjetor 2023</b>                         | <b>4,333</b>                      | <b>2,193</b>                          | <b>6,526</b>             |
| Bilanci më 1 Janar 2024                                   | 4,333                             | 2,193                                 | 6,526                    |
| Rregullimi për balancat e viteve<br>paraprake për SNRF 16 | -                                 | 241                                   | 241                      |
| <b>Bilanci më 1 Janar 2024 pas<br/>Rregullimit</b>        | <b>4,333</b>                      | <b>2,434</b>                          | <b>6,767</b>             |
| Fitimi për vitin                                          | -                                 | 1,137                                 | 1,137                    |
| Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse                       | -                                 | -                                     | -                        |
| <b>Bilanci më 31 Dhjetor 2024</b>                         | <b>4,333</b>                      | <b>3,571</b>                          | <b>7,904</b>             |

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri 28 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave  
financiare.

**KOMPANIA E SIGURIMEVE ELSIG SH.A.**  
**Pasqyra e Rrjedhës së Parasë**  
**Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2024**

|                                                                                   |          | Për vitin që ka<br>përfunduar më<br>31 Dhjetor 2024<br>(në EUR'000) | Për vitin që ka<br>përfunduar më<br>31 Dhjetor 2023<br>(në EUR'000) |
|-----------------------------------------------------------------------------------|----------|---------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------|
|                                                                                   | Shënim   |                                                                     |                                                                     |
| <b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative</b>                                 |          |                                                                     |                                                                     |
| Fitimi neto për vitin                                                             |          | 1,137                                                               | 623                                                                 |
| <b>Korrigjuar për:</b>                                                            |          |                                                                     |                                                                     |
| Zhvlerësimi dhe amortizimi                                                        | 13,14    | 126                                                                 | 96                                                                  |
| Zhvlerësimi i aseteve me të drejtën e përdorimit                                  |          | 506                                                                 | 358                                                                 |
| Të hyrat nga interesi                                                             |          | (773)                                                               | (589)                                                               |
| Shpenzimet e interesit                                                            |          | 28                                                                  | 22                                                                  |
| Rregullimi për balancat e viteve paraprake për SNRF 16                            |          | 241                                                                 | -                                                                   |
| Provizionet për borxhet e këqija                                                  |          | 981                                                                 | 682                                                                 |
| <b>Fitimi operativ para ndryshimeve në asete dhe detyrime</b>                     |          | <b>2,246</b>                                                        | <b>1,192</b>                                                        |
| <br>                                                                              |          |                                                                     |                                                                     |
| Rritja në kostot e shtyra të blerjes                                              |          | (225)                                                               | (125)                                                               |
| Rritja në llogaritë e arkëtueshme                                                 |          | (1,128)                                                             | (359)                                                               |
| Rritja në pjesën e risiguruesve të detyrimeve (Rritja)/zvogëlim në pasuritë tjera |          | (1,444)                                                             | (450)                                                               |
|                                                                                   |          | (348)                                                               | 47                                                                  |
| Rritja në detyrimet bruto të dëmeve                                               |          | 3,071                                                               | 1,709                                                               |
| Rritja në provizion për primet e pafituara                                        |          | 1,962                                                               | 215                                                                 |
| Rritja në detyrimet nga sigurimi                                                  |          | 235                                                                 | 62                                                                  |
| (Zvogëlim)/rritja në detyrimet tjera                                              |          | (661)                                                               | 192                                                                 |
| <b>Neto paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative</b>                          |          | <b>3,708</b>                                                        | <b>2,483</b>                                                        |
| <br>                                                                              |          |                                                                     |                                                                     |
| <b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese</b>                                |          |                                                                     |                                                                     |
| Blerja e aseteve fikse                                                            |          | (463)                                                               | (186)                                                               |
| Rritja e depozitave me afat                                                       |          | (2,655)                                                             | (1,074)                                                             |
| Ndryshimi në investime në letra me vlerë                                          |          | (503)                                                               | 66                                                                  |
| Interesi i pranuar                                                                |          | 773                                                                 | 589                                                                 |
| <b>Paraja e përdorur në aktivitetet investuese</b>                                |          | <b>(2,848)</b>                                                      | <b>(605)</b>                                                        |
| <br>                                                                              |          |                                                                     |                                                                     |
| <b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</b>                                |          |                                                                     |                                                                     |
| Pagesat e qirasë                                                                  |          | (539)                                                               | (385)                                                               |
| Pagesa e dividendës                                                               |          | -                                                                   | (1,000)                                                             |
| <b>Paraja e përdorur në aktivitetet financuese</b>                                |          | <b>(539)</b>                                                        | <b>(1,385)</b>                                                      |
| <br>                                                                              |          |                                                                     |                                                                     |
| <b>Neto rritja e parasë dhe ekuivalentëve të parasë</b>                           |          | <b>321</b>                                                          | <b>493</b>                                                          |
| Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit                               |          | 2,118                                                               | 1,625                                                               |
| <b>Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit</b>                          | <b>7</b> | <b>2,439</b>                                                        | <b>2,118</b>                                                        |

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri 28 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.